

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-055/12**

**Prishtinë, 25 qershor 2013**

Në çështjen juridike të

**B. M. S.**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtaret Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/128/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA06328), të datës 26 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 25 qershor 2013, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1- Pranohet si e bazuar ankesa e B. M. S.**
- 2- Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/1280/2011 i datës 26 tetor 2011 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA06328, ndryshohet si vijon:**

**Ankuesi ka dëshmuar se ai është pronari i ngastrës nr. 662, që gjendet në komunën e Gjakovës, zona kadastrale Hereç, në sipërfaqe prej 3 ha, 79 ar dhe 88 m<sup>2</sup>.**

**Ankuesit i pranohet e drejta pronësore.**

**Kushdo që ka uzurpuar pronën urdhërohet ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij aktgjykimit.**

**Nëse ndonjë person që ka uzurpuar pronën nuk e zbaton këtë urdhër për ta liruar pronën e kërkuar brenda afatit të caktuar, do të dëbohet nga prona.**

#### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Më 10 janar 2007, B. M. S. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon njohjen si pronar i pronës që gjendet në Hereç në Gjakovë, ngastra nr. 662, arë e klasës 5 në sipërfaqe prej 3 h 79 ar 88 m<sup>2</sup>, dhe re-posedimin. Ai shpjegoi se tokën e ka marr në bazë të trashëgimisë, ndërsa e ka humbur më 13 qershor 1999 dhe arsyeja pse e ka humbur ishte për shkak të rrethanave të vitit 1998/1999 në Kosovë. Ai deklaroi se familja B. e ka uzurpuar ngastrën. Lënda është regjistruar në AKP me nr. KPA06328.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka ofruar për AKP-në mes tjerash fletën poseduese nr. 161, të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, zona kadastrale Hereç me 25 prill 2005 (UNMIK), që tregon se ngastra me nr. 662 është regjistruar nën emrin e B. S.. Fleta poseduese mund të verifikohet.

Më 7 qershor 2010, ekipi vlerësues i AKP-së ka dal tek vendi ku supozohej të jetë ngastra e kërkuar dhe ka vendosur një shenjë duke treguar se prona është objekt i një kërkesë dhe se palët e interesuara është dashur të kenë paraqitur përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Prona (livadhi) është gjetur e uzurpuar. Ekipi verifikues ka kontaktuar me familjen B., që deklaroi se nuk e kanë shfrytëzuar pronën. Më 9 qershor 2010, verifikimi është bërë në bazë të ortofotografimit dhe GPS koordinatave, dhe doli të jetë në rregull.

Më 5 prill 2010, një zyrtar i AKP-së ka kontaktuar me paraqitësin e kërkesës (si duket përmes telefonit) lidhur me rastin paralel GSK-KPA-A-150/11 (KPA06330). Në këtë rast, uzurpuesi ka thënë se përmes kontratës të datës 26 dhjetor 1997, paraqitësi i kërkesës ia ka shitur një ngastër atij. Paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se ka pranuar 45.000 DM për këtë ngastër, por që pjesa prej 40.000 DM nuk i janë paguar ende. Për më shumë

paraqitësi i kërkesës ka konfirmuar se është transferuar në Kruševac në vitin 1997 sepse djali i kishte vdekur dhe prej asaj kohe nuk e kishte shfrytëzuar pronën.

Më 26 tetor 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e vetë KPCC/D/A/128/2011 hodhi poshtë kërkesën për shkak se nuk ishte nën juridiksion të KKPK-së. Meqë paraqitësi i kërkesës është transferuar në Kruševac në vitin 1997, KKPK-ja vendosi që paraqitësi i kërkesës e ka humbur të drejtën e posedimit qysh në vitin 1997. Prandaj, humbja e posedimit nuk ka qenë për shkak të rrethanave direkt të ndërlidhura me ose si rezultat i konfliktit 1998/1999.

Vendimi i është dërguar paraqitësit të kërkesës më 8 mars 2012. Më 4 prill 2012, paraqitësi i kërkesës (këtëj tutje: pala ankuese) ka paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme, duke atakuar vendimin e KKPK-së për shkak të shkeljeve të rënda të së drejtës materiale dhe procedurale të aplikueshme dhe vërtetimit të gabueshme dhe jo të plotë të fakteve.

Pala ankuese ka deklaruar se ai asnjëherë nuk është transferuar në Kruševac por ka shkuar atje përkohësisht në vitin 1998, për shkak të sëmundjes së rëndë të vëllait të tij. Pas vdekjes së vëllait të tij ai u kthye në Gjakovë, ku qëndroi deri në qershor 1999 kur u largua për shkak të situatës jo të sigurt në Kosovë. Që nga qershori 1999 ai jetoi në Leposaviq. Për të mbështetur pretendimet e tij, ai paraqiti një kopje të letërnjoftimit, një kërkesë për pension dhe një kopje të kartelës së bankës.

Pala ankuese kërkon që ankesa të zgjidhet në favor të tij, që vendimi i KKPK-së të anulohet dhe t'i njihet e drejta pronësore.

### **Arsyetim ligjor:**

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Ankesa po ashtu është e bazuar.

1. Gjykata gjen se lënda është në juridiksion të Gjykatës.

- a. Gjykata supozon se humbja e pronës është e ndërlidhur direkt me luftën. Gjykata vëren se pala ankuese ka informuar AKP-në se ai është transferuar në Kruševac qysh në 1997. Sidoqoftë, Gjykata gjeti të dhëna mbi një ujdë gjyqësore të datës 21 janar 1998 e përpiluara në Gjykatën Komunale të Krushevcit. Në këto të dhëna adresa e palës ankuese është e shkruar në Gjakova, madje janë dhënë edhe rruga dhe numri i shtëpisë. Në vendimin e Drejtorisë së Republikës për Gjeodezi në Gjakovë, BR.952-01-1/98-53-C të datës 17 shkurt 1998, ekziston e njëjta adresë e palës ankuese. Këto fakte mbështesin pretendimet e paraqitësit të kërkesës se ai është larguar përgjithnjë në Krushevc vetëm në vitin 1999 për shkak të konfliktit. Për më tepër, në këtë ujdë gjyqësore të përmendur, adresa e vëllait të paraqitësit të kërkesës, është ajo në Krushevc. Kjo po ashtu nënkupton edhe deklaratën e palës ankuese, se ka shkuar përkohësisht në Krushevc në vitin 1998 për shkak të sëmundjes së vëllait të tij. Gjykata dëshiron të shtojë se kjo nuk e kundërshton informatën e dhënë në AKP nga pala ankuese, sikurse nuk mund të përjashtohet se ai fillimisht ka shkuar në Krushevc në vitin 1997 dhe pastaj përsëri në vitin 1998.
  - b. Gjykata po ashtu nuk ka dyshime se prona është pronë private. Sipas vendimit BR.952-01-1/98-53-C të datës 17 shkurt 1998 të Drejtorisë së Republikës për Gjeodezi në Gjakovë, prona është dashur të jetë e regjistruar si pronë private e B.(M.) S., palës ankuese.
2. Pala ankuese po ashtu ka dëshmuar të drejtën e tij pronësore.

AKP-ja përveç Fletës Poseduese të UNMIK-ut nr. 161, të lëshuar më 14 prill 2011 të zonës kadastrale të Hereçit, në komunën e Gjakovës, që tregon se ngastra nr. 662 është e regjistruar në emër të B. S., AKP-ja po ashtu gjeti Certifikatën për të Drejtën mbi Pronën e Palujtshme UL-70705030-00161 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës më 2013 për zonën kadastrale të Hereçit. Certifikata po ashtu tregon se B. S. është pronar/posedues i ngastrës nr. 662. Sipas nenit 124 të Ligjit Nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, nëse e drejta – këtu e drejta e pronësisë e ankuesit në parcelë – ishte regjistruar në regjistrin mbi palujtshmëritë në emër të një personi, prezumohet që ai person ka të drejtë në të drejtën e tillë të regjistruar.

3.

Rrjedhimisht, vendimi i KKPK-së duhet të korrigojohet, të konfirmohet pronësia e palës ankuese dhe të urdhërohet rimarrja në posedim.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Pasi që pala ankuese fiton rastin, ai nuk duhet të paguajë asgjë.

**Këshillë juridike:**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**